



The Norwegian Helsinki Committee, Kirkegata 5, 0153 Oslo, Norway
Tel: (+ 47) 22 47 92 02 – Fax: (+ 47) 22 41 60 76 – Bankaccount: 5001 06 26061
Org no.: 959 196 451 – Homepage: www.nhc.no

INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR PROJEKTIN

„NDËRTO URA, JO MURE: Roli i universiteteve në ndërtimin e paqes”

„Ndërto ura, jo mure: Roli i universiteteve në ndërtimin e paqes” është një program rajonal i Komitetit Norvegjez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KNH), me qëllim që të zhvillojë bashkëpunimin mes shoqërisë civile dhe universiteteve në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi, në fushat e mirëkuptimit ndërkulturor, të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes.

Qëllimi është që të ndërtohen kompetenca të universiteteve/partnerëve në programin që do t’iu mundësojë atyre t’i edukojnë studentët në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e kulturës demokratike të bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor. Me njohuritë për mirëkuptimin ndërkulturor, të drejtat e njeriut dhe proceset që nevojiten për ndërtimin e paqes, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor për grupet përkatëse profesionale në rajon, ata do të jenë promotorë të vlerave në vendet e punës në ardhmën.

Fillimisht programi i paraqet lëndët zgjedhore në universitetet e Kosovës, Bosnjës e Hercegovinës dhe Serbisë. Kjo do të jetë hera e parë që tri lëndët tematike - mirëkuptimi ndërkulturor, të drejtat e njeriut, rindërtimi i besimit dhe ndërtimi i paqes, shfaqen si lëndë e përbashkët në universitetet e rajonit. **Ky studim është gjithashtu një bazë për aktivitetet në universitet, që çojnë në identifikimin e rolit të fakulteteve dhe universiteteve në ndërtimin e paqes në rajon.**

Programi parashikon veprimtaritë e mëposhtme:

- Të fusë studimin e mirëkuptimit ndërkulturor, të drejtave të njeriut dhe proceseve të ndërtimit të paqes. Studimi është organizuar edhe për studentët me orar të plotë dhe për studentët në punë¹;
- Të ndihmojë në zhvillimin e letërsisë në lidhje me vlerat e përmendura më lart;
- Të krijojë këndin për mirëkuptimin ndërkulturor dhe të të drejtave të njeriut në bibliotekat e 5 universiteteve në rajon;
- Të organizojë 5 konferenca për ndërtimin e paqes në universitetet partnere dhe 1 konferencë rajonale mbi rolin e universiteteve në ndërtimin e paqes;
- Të zbatojë hulumtim të gjerë në proceset e ndërtimit të paqes në vendet e përmendura dhe zhvillimin e raportit me përfundimet dhe rekomandimet për punë të mëtejshme në këtë fushë;
- Të zhvillojë strategjinë e veprimit në universitetet në ndërtim të paqes, që do të jetë i menduar për universitetet, për institutet pedagogjike dhe për ministrinë përkatëse në rajon.

Grupet e targetuara të programit janë:

- Studentët me orar të plotë,
- Studentët në punë,
- Stafi arsimor dhe stafi administrativ në universitete,
- Institucionet arsimore, ministrinë e caktuara dhe institutet pedagogjike.

¹ Studim për personat e punësuar që gjejnë këto kompetenca të nevojshme për të mësuar për vendin e tyre të punës, p.sh. pedagogë, mësues, gazetarë, punonjës socialë etj

Stafi arsimor do të konsolidojë edhe njohuri teorike (universitetet) dhe më shumë përvojë praktike në lëndët e njëjta (OJQ). Programi parashikon shkëmbimin e mësuesve dhe studentëve ndërmjet universiteteve, kurrikulë dhe program të përbashkët dhe bashkëpunimin midis universiteteve në zhvillimin e materialeve edukative.

Zhvillimi i sistemit arsimor është një nga prioritetet e këtyre vendeve dhe kështu Komiteti Norvegjez i Helsinkit (KNH) është i angazhuar për të mbështetur përpjekje të tilla. Në fazën e parë të implementimit të tij, programi do të zgjasë tre vjet.

Rreth organizatorit

Komiteti Norvegjez i Helsinkit (KNH) është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare, e themeluar në vitin 1977, me një zyrë qendrore në Oslo. KNH-ja punon për të siguruar që të drejtat e njeriut respektohen në praktikë, nëpërmjet monitorimit, raportimit të mësimdhënies dhe mbështetjes së demokracisë. Komiteti Norvegjez i Helsinkit veçanërisht punon në vende të Europës, Azisë Qendrore dhe Amerikës Veriore. Projektet e KNH-së mbështeten nga donatorët vendës dhe ndërkombëtarë, publikë dhe privatë, prej të cilëve MPJ norvegjeze është më e madhja dhe më e rëndësishmja.

Rreth partnerëve

KNH së bashku me partnerët e tij dëshiron të krijojë një platformë për bashkëpunim mes shoqërisë civile dhe universiteteve, në mënyrë që të zhvillojnë forma të reja, masa dhe arena për rindërtimin e besimit dhe pajtimin në nivelin universitar.

Komiteti Norvegjez i Helsinkit dhe komitetet e Helsinkit për të drejtat e njeriut në Bosnjë e Hercegovinë tashmë tre vjet e kanë zbatuar programin për arsim në mirëkuptimin ndërkulturor dhe rindërtimin e besimit në sektorin e arsimit formal.

Në vitet e ardhshme, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti i Helsinkit në BeH, Komiteti i Helsinkit në RS e Serbi dhe universitetet do të bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e kësaj lënde zgjedhore në bashkëpunim me aktorët kryesorë në këtë fushë në BeH, Serbi dhe Kosovë.

Informacioni i kontaktit:

Enver Duliman
Kreu i Departamentit të Arsimit për të Drejtat e Njeriut
Komiteti Norvegjez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
Adresa: Kirkegata 5, N-0153 Oslo, Norvegji
E-mail: djuliman@nhc.no
Telefoni: +4790559202
www.nhc.no